



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të vendimit nr.20/2020, datë 13.03.2020, të nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Financave dhe Transfereve, Drejtoria e Financave-Spektori i Tatimit në Pronë në Komunën e Prishtinës bën këtë;

## N J O F T I M

Njoftohen tatimpaguesit e komunës së Prishtinës, se për shkak të situatës së krijuar nga sëmundja COVID -19 dhe shtyrjes së afatit të lëshimit të faturave për tatim në pronë deri më 31.03.2020, shtyhen afatet ligjore për vitin 2020 për pagesën e detyrimeve të këstit të parë të tatimit në pronë dhe paraqitjes së ankesave dhe kërkesave për korrigjim ndaj faturave të tatimit në pronë dhe certifikatave të vlerave të vlerësuara dhe atë si në vijim:

- Afati për pagesën e këstit të parë për detyrimet e tatimit në pronë shtyhet deri më 30 qershor 2020, (në vend të 30 prill 2020);
- Afati për pagesën e këstit të dytë për detyrimet e tatimit në pronë deri më 30 shtator 2020, (mbetet e pandryshuar);
- Afati për paraqitjen e ankesës dhe kërkesës për korrigjim ndaj faturës së tatimit në pronë dhe certifikatës së vlerës së vlerësuar shtyhet deri më 31 maj 2020, (në vend të 31 mars 2020).

Për çdo vendim tjetër të nxjerr nga autoritet kompetente, do të njoftohen me kohë të gjithë tatimpaguesit e komunës së Prishtinës.

### Vëmendje:

Mund të shfrytëzoni platformën digjitale për shkarkimin e faturës së tatimit në pronë dhe pagesat on-line duke vizituar faqet <https://fatura.tatimineprone-rks.org> dhe Si të paguaj online?

Për çdo informatë më të hollësishme kontaktoni Drejtorinë e Financave-Spektori i Tatimit në Pronë në Komunën e Prishtinës përmes postës elektronike [ZTP.Prishtina@rks-gov.net](mailto:ZTP.Prishtina@rks-gov.net)